

FJALA E DEPUTETIT XHELAL MZIU

E MËRKURË 9 NËNTOR 2022

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar qytetarë,

Gjatë gjithë ditës së sotme u fol për një buxhet që është dyfishuar, një buxhet që do të sjellë lumturi, një buxhet që bëhet në kohë lufte, dhe, në fakt, pavarësisht se në shifra, në raport me vitin 2013, është dyfishuar buxheti, po ta krahasoni me standardin e para vitit 2013 produkti është përgjysmuar, krahasuar me vitin 2013, edhe pse është dyfishuar. Është dyfishuar buxheti jo se është rritur mirëqenia, jo se është rritur Shqipëria, jo se është rritur numri i bizneseve, por se rritja e taksave dhe e tatimeve ka qenë prologu kryesor i kësaj qeverie në këta 10 vjet.

Vetëm këtë qeveri, edhe në kohë lufte, shoh që krenohet kur dyfishohet buxheti. Në fakt, fiks në vitin e luftës, që ju i thoni vit lufte, se lufta nuk ka fare lidhje me Shqipërinë, u keni marrë qytetarëve shqiptarë jo pak, por 500 mijë euro më shumë sesa një vit më parë për shkak të rritjes së çmimit, për shkak të taksave më të larta se asnjë vend tjetër. Në fakt, ju u keni dhënë qytetarëve shqiptarë jo dyfishin e pagave, jo dyfishim pensioni, jo dyfishim të ndihmës ekonomike apo të numrit të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, por u keni dhënë, ua keni servitur ato 50 milionë euro, që janë 10-12 herë më pak sesa keni përfituar. Është i vetmi buxhet shtetëror në botë që ka përfituar nga kriza, dhe kjo është alarmante. Përse nuk i rrisni pagat? Nëse nuk i rrisni dyfish, pse nuk i rrisni, të paktën, sa inflacioni? Ne sot e kemi inflacionin 8%-9%. Meqenëse të ardhurat janë rritur 16% më shumë sesa vitin e kaluar, pse nuk u rritën, të paktën 8%-10%?

Në fakt, situata e vështirë nuk ka ardhur vetëm për shkak të rritjes së pagave, por edhe për shkak të rritjes së të ardhurave, edhe për shkak të rritjes së borxhit. Ne kemi përfituar jo vetëm 500 milionë euro më shumë çdo vit, por në mënyrë permanente ne kemi marrë borxh dhe shifra ka shkuar atje ku nuk mban më, jo vetëm që është rritur, por vitin që vjen do të paguajmë më shumë sesa 1,1 miliardë euro, edhe principal, edhe interesa për shkak të kredive. Të mos harrojmë se vazhdojmë, në çdo mbledhje që bëjmë, të marrim kredi, për të mos thënë që në vitin e ardhshëm do të kemi peshqesh edhe ndonjë Eurobond tjetër, më shumë sesa 500 milionë euro.

Kjo është situata që keni krijuar ju. Nëse është dyfishuar buxheti, pse nuk është rritur mirëqenia?! Pse kanë ikur 800 mijë shqiptarë në 8 vjet, madje në Angli shkojnë me gomone njëpërdorimshme? Nuk ikin për qejf, nuk janë turistë, por ikin për të siguruar bukën e gojës dhe për të luftuar shesh-besh, nëse e kalojnë apo jo kanalin, bashkë me familjen.

Kjo është situata që keni krijuar dhe nuk është vetëm kjo, se po të shikosh infrastrukturën, pavarësisht se kemi rritje të buxhetit, infrastruktura ka pasur një rritje shumë më të vogël sesa duhet të kishte. Nuk konvertohet në më shumë investime, sepse paratë e infrastrukturës kanë shkuar për PPP-të, madje edhe në 10 PPP të tjera, që nuk e dimë se çfarë janë ato.

Më kryesorja është se ka edhe një diskriminim të ndarjes së investimeve në Shqipëri. As 20% të asaj që u takon, nuk kanë marrë 4 qarqet e Veriut. Mjafton të shikosh akset kryesore Rrëshen-Milot, Milot-Balldren- Shkodër apo Thumanë -Kamzë e mjaft investime të tjera, që duhet të kishin mbaruar, por që nuk kanë ndër mend të fillojnë e jo të mbarojnë.

Në qarkun e Dibrës duhej të mbaronte unaza lindore e Shqipërisë, nga ura e Çerenecit për t'u lidhur me Librazhdin, që duhej të kishte mbaruar para 10 vjetësh, por as e kanë ndër mend ta fillojnë. Janë më shumë sesa 60% e komunave të qarkut të Dibrës që nuk kanë asfalt deri në qendër të komunës. Kjo është situata e krijuar. Më shumë se 75% e fshatrave nuk kanë ujë për të pirë, më shumë sesa 80% e zonave bujqësore nuk kanë ujë për vaditje. Thuhet se do të shkojë 75% vaditja, 95% furnizimi me ujë, por është totalisht një situatë që nuk ka asnjë lloj të krahasuare.

Shohim se shkojnë miliona euro për PPP-të. Ishim në Kroaci bashkë me kolegë të krahut të majtë dhe atje nuk kishte inceneratorë, por landfille. Kroacia është vendi më turistik i botës dhe nuk i aplikonte, sepse ato kanë një kosto marramendëse. Ne kemi bërë 4 landfille, madje bëhet transporti nga një qark në një tjetër, me kosto marramendëse, me financim nga buxheti i shtetit, sepse ka interesa personale. Kjo është shumë e frikshme, e dhimbshme. Madje, vazhdohet edhe më tej. Po të shikosh qarqet e tjera si ai i Dibrës, ka hotspot-e, ku nuk paguhet asnjë qindarkë nga buxheti i shtetit. Nuk them të bëhet incenerator, sepse do të krijonte një plagë tjetër, por mund të bëhet një landfill, mund të bëhet groposja e tyre, ose rrethimi që mos të jetë një pamje e keqe për turistët. Kjo është situata që keni krijuar.

Për të vazhduar me bujqësinë, ku mbi 80% e sipërfaqes në qarkun e Dibrës nuk punohet, sepse nuk ka vaditje, nuk ka mbështetje, sepse bujqësia në Shqipëri mbështetet vetëm me 3 euro për hektarë drejtpërdrejt. Kosova e ka 45 euro për hektarë, Maqedonia e Veriut mbi 65 euro për hektarë. Ju krenoheni se u jepni 30 milionë lekë të vjetër për hektarë për grurin. Në Shqipëri 90% e tokave janë më

pak sesa një hektarë dhe nuk e përfitojnë. Nuk e kuptoj pse të ketë këtë lloj diskriminimi. Qytetarët e Dibrës, por edhe të Shqipërisë shkojnë e blejnë produkte bujqësore jashtë kufijve, sepse atje produktet bujqësore subvencionohen me 45-65 euro për hektarë, subvencionohet qumështi, produkti, subvencionohen kokët e blegtorisë.

Blegtoria te ne ka një rënie drastike. E pyeta ministren në komision dhe nuk e dinte akoma se sa është numri i blegtorisë. Në 4 vjetët e fundit ka një rënie 2-3 herë më pak sesa më parë. Ajo u shpreh se: “Tani të rinjtë e sotëm nuk shkojnë te blegtoria”. Nuk ka sesi të shkojnë, sepse nuk ka treg, nuk ka mbështetje, ka konkurrencë të pandershme. “Open Balkan” ka krijuar një situatë të pakëndshme. Me “Open Balkan” vëllai i vogël i Vuçitit ka krijuar këtë lloj situatë të pakëndshme për bujqësinë, e ka falimentuar biznesin, e ka ndrydhur bujqësinë, si një element kryesor, ku janë të punësuar shumica e qytetarëve shqiptarë. I ka imponuar ata për të ikur jashtë shtetit, sepse është e pamundur për të mbijetuar.

Për të vazhduar me pushtetin vendor, që për 6 muaj u bë ec e jake për të pasur një hartë elektorale dhe për t’i dhënë një kompetencë. Hartën nuk e bëtë, sepse doli një hartë politike. Nuk i dhatë as kompetenca. Vazhdon të kemi vetëm 1% të PBB-së, që jepet në fillim të vitit, kur vendet që janë më afër nesh e kanë 4%-5% deri në 15%. Jo vetëm kaq, por ju nuk dhatë pjesën e taksave kombëtare, asgjë nuk është planifikuar për vitin që do të vijë. Kjo është e dhimbshme. Madje edhe funksionet e deleguara nuk mjaftojnë për atë çfarë ju i keni deleguar, ka një kosto shtesë për pushtetin vendor. Kjo është situata që keni krijuar sot. Nuk mbyllet me kaq, por edhe fondet që jepen nga qeveria nuk u jepen bashkive, por jepen nëpërmjet FSHZH-së, duke krijuar një disproporcion të shpërndarjes së buxhetit të shtetit edhe te pushteti vendor. Pra, nuk keni lënë instrument pa prekur, nuk keni bërë një buxhet që shkon në ndihmë të qytetarëve, vetëm këtu ndodh që konsumit nuk i jepet rëndësi.

INSTAT-i shkruante sot se 44% është rritur importi i zarzavateve, një shifër rekord krahasuar me 20 vjet më parë, sepse nuk ka leverdi dikush të ketë serën, sepse nafta kushton më tepër sesa në vendet e tjera të rajonit, sepse energjia është 2 herë më shumë për bizneset e mëdha. Kanë mbyllur fabrikat e çimentos, kanë mbyllur fabrikat e shkrirjes së hekurishteve dhe ndërkohë është krijuar një situatë të pakëndshme. Kemi papunësi ndaj rriteni, të paktën, pagën.

Është e paimagjinueshme, që vetëm në Universitetin Bujqësor të Kamzës, nga 680 vetë që duhet të ishin te Fakulteti i Bujqësisë, janë regjistruar vetëm 180 vetë, 500 më pak, sepse nuk i mbështesni as me

personel, as më subvencionim. Pastaj kërkoni të keni një bujqësi të zhvilluar. Kjo është situata që keni krijuar.

Pavarësisht se ju krenoheni me dyfishimin e këtij buxheti, vota ime është kundër, sepse është buxheti i varfërisë, i papunësisë dhe i shpopullimit të vendit.

Faleminderit!